



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI**

**VENDIM**

**Nr. 101/2018**

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KUVENDIT NR. 92/2017 “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT”**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të nenit 18, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. “Lidhja nr.1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, e vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 1, “Organika dhe klasifikimi i pagave të Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Lidhja nr. 2, “Struktura organizative e Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, e vendimit të Kuvendit nr. 92/2017, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2, “Struktura organizative e Kolegjit të Posaçëm të Apelit”, që është pjesë përbërëse dhe i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 4.10.2018

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË  
APELIMIT**

<b>FUNKSIONI ORGANIK</b>	<b>Klasifikimi i pagës</b>	<b>Numri</b>
<b>I. KRYETAR</b>	G3*	(2)
Sekretar	Sekretar në kabinetin e kryetarit të Kuvendit**	1
<b>II. KOLEGJI I GJYQTARËVE</b>		<b>(6)</b>
Gjyqtarë	G3*	<b>6</b>
<b>III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR</b>		(14)
Këshilltarë juristë	80% e G3*	7
Këshilltarë ekonomistë	80% e G3*	7
<b>IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM</b>	I-a	1
<b>V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN</b>		(11)
Drejtor	II-b	1
Specialist sekretarie gjyqësore	III- b	3
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-a	1
Përkthyes	II-b	4
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	III-a	1
Specialist pritje me popullin	IV-a	1
<b>VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>		(9)
Drejtor	II-b	1
Specialist financë/buxhet	III-b	1
Specialist i burimeve njerëzore	III-b	1
Specialist IT ***	III-b	2
Specialist protokoll/arkivë****	IV-a	1
Magaznier	VII	1
Punonjës pastrimi	III	1
Shofer/Korrier	VI	1
<b>Total</b>		<b>43</b>

*Shënim:*

*\*Paga e gjyqtarit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit përlllogaritet me këtë formulë: G3 + 10% G3 + shtesën për vjetërsi (e barazvlefshme me pagën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.*

*\*\*Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit, është sipas vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*\*\*\* Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*\*\*\*\* Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*\*\*\*\*\* Përfitimet për kushtet e vështirë e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.*

### STRUKTURA ORGANIZATIVE E KOLEGJIT TE POSACEM TE APELIMIT

